



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:149704

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05447844

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.767/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit H..... H..... për shkak të veprës penale: Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të Kodi Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1271/2017, të datës 10.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 12.02.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Arjan Xhema, i pandehuri H..... H....., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Faruk Korenica, me datë 15.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 13.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H.... H...., me nofken "Sh....", nga i ati A..., e ëma R...., e vajzërisë Q..., i lindur më datë 26.01.1969, në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në Rr. "A... V...", nr. ..., L... e R...., i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 05.02.2017, rreth orës 17:45, në rrugën. "A... V...", në lagjen e romëve në Mitrovicë e ka sulmuar personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, R... N... – zyrtar policor, ashtu që të dëmtuarin i cili me kolegun e vet po e vendoste rendin në mesin e qytetarëve të cilët ishin mbledhur rreth një shtëpie që po digjej, pas së cilës është veçuar nga masa e njerëzve dhe e ka goditur me grusht në regjionin e kokës, dhe me atë rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjes së indeve të buta të kokës dhe qafës.

Me këtë ka kryer veprën penale: Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 73, 74 dhe 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Pala e dëmtuar, R... N..., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore – juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1271/2017 të datës 10.07.2019, kundër të pandehurit H...H... për shkak të veprës penale: Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 24.12.2020, 05.12.2023, 09.01.2024 07.02.2024, dhe 12.02.2024 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri H...H..., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Faruk Korenica. Në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i vihej në barrë, ndërsa gjykata ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin R... N..., dëshmitarët H... K..., I... K..., A... K... dhe F... P..., ka administruar provat materiale dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.1271/2017, të datës 01.07.2019 ndaj të pandehurit H...H... në drejtim të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 402 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, se i pandehuri e ka kryer veprën penale të lartcekur në ditën kritike e kishte sulmuar zyrtarin policor i cili kishte qenë në kryerjen e detyrës zyrtarin të dëmtuarin R... N..., i cili kishte qenë në vendosje të rendit ku pranë një shtëpie e cila po digjej ishin mbledhur shumë qytetarë dhe i pandehuri ishte veçuar nga masa e njerëzve dhe e kishte goditur të dëmtuarin, me ç ‘rast i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore. Tutje, ka shtuar se edhe përkundër mohimit kategorik të pandehurit se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale, me provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga dëshmia e të dëmtuarit R... N..., nga dëshmitari F... P... vërtetohet se jo vetëm që është kryer vepra penale por edhe që i

pandehuri ka qenë kryerës i kësaj veprë penale. Andaj nga të lartcekurat më lartë, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor, ta dënoj sipas ligjit duke i marrë të gjitha rrethanat rënduese dhe atë peshën e veprës penale, mënyra dhe rrethanat e kryerjes, vlerën e mbrojtur dhe si rrethanë lehtësuese të merret parasysh se i pandehuri ka qenë korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Mbrojtësi i të pandehurit H...H..., avokat Faruk Korenica, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar vetëm se i mbrojturi im e ka sulmuar të dëmtuarin R.... N...., por nuk ka precizuar përshkrimin e sulmit se në cilën pjesë janë shkaktuar lëndimet e lehta trupore, nuk përmendi as certifikatën mjekësore, raportin mjekësor dhe as dëshmitarët të cilën kanë dhënë deklaratat e tyre në shqyrtimet gjyqësore, sipas dispozitave të KPP-së. Tutje, ka theksuar se prokurori aktakuzën e ka mbështetur vetëm në dy deklarata të dëshmitarëve R.... N.... dhe F..... P...., dëshmitari R.... ka dhënë dy deklarata, një në polici dhe një në shqyrtim gjyqësor dhe në asnjë deklaratë nuk ka thënë se ka pa se ky person ka sulmuar të dëmtuarin me grusht në regjionin e kokës, ndërsa R.... ka thënë se lëndimin ia ka shkaktuar në kurriz dhe po ashtu i dëmtuari R.... ka deklaruar se mjeku nuk ka konstatuar ndonjë lëndim. Dëshmitari F.... P... ka rënë në kundërtënie të plotë me atë çfarë ka deklaruar në shqyrtim dhe polici, se lëndimi i të dëmtuarit bazohet në raportin e spitalit 05.02.2017, në të cilin nuk shkruan mjeti me të cilin e ka goditur ndërsa në raportin e ekspertizës mjeko ligjore të datës 16.11.2018. mendimin e tij e ka bazuar vetëm në fotografi që gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu dëshmitari Q.... G... ka përmendur emra të tjerë të cilët e kanë sulmuar të dëmtuarin por jo emri i të mbrojturit tim. Më tej ka shtuar se meqenëse i dëmtuari ka deklaruar se nuk pasur lëndime, nuk kemi të bëjmë me elementin e veprës penale dhe meqenëse nuk kemi pasur lëndime atëherë kemi të bëjmë me veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se veprës penale nga neni 410 par.1 të KPRK-së, në të cilën me këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej 3 deri ne tre vjet dhe kemi të bëjmë me parashkrim absolut, dhe në fund mbrojtësi ka theksuar se dëshmitari kur e ka përshkuar të pandehurin ka deklaruar se ka mjekër ndërsa i njëjti nuk ka mjekër.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet fjalën e mbrojtësit dhe ka deklaruar se nuk e ka kryer veprën penale.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtura me datë 24.12.2020, 05.12.2023, 09.01.2024 07.02.2024, dhe 12.02.2024, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin R.... N...., dëshmitari H.... K...., I.... K...., A... K...., F.... P.....

I dëmtuari – dëshmitari R... N...., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 05.12.2023, i cili mes të tjerash ka deklaruar, se ka qenë i sulmuar ne lagjen e romëve, nuk i kujtohet saktësisht as data e as viti, kemi qenë në detyrë me kolegun F.... P.... dhe kanë pranuar informata se është duke u djegur një shtëpi, kanë shkuar në lokacion, shtëpia ishte duke u djegur dhe kishte pasur një turmë të madhe të njerëzve, banorë të lagjes, disa kishin hipur mbi shtëpi, disa në mure dhe mundoheshin të ndihmonin në fikjen e zjarrit, kur kanë mbërri, ka pasur një revoltë ndaj tyre duke iu thënë “pse jeni vonuar, ku mbetet deri tash” etj. Pastaj kanë ardhur zjarrfikësit dhe kanë kërkuar nga ata që t’i largojmë banorët nga aty në mënyrë që ata të

mund të punojnë në fikjen e zjarrit. Më tej ka shtuar se janë munduar me kolegun F.... që t'i largojmë, bile e di që e kanë kapur një djalë dhe i kanë thënë të largohet nga aty dhe ai i është kthyer me fjalët *“mua mu ka djegur shtëpia, ju spo boni kurrjo, jeni ardh me bo hajgare”* pra i njëjti ka rezistuar ndaj kërkesave të tyre dhe e ka kapur ta largojë dhe në atë moment dikush e ka goditur nga mbrapa në shpinë në mes të qafës dhe shpinës, kur është kthyer, kolegu F... ka qenë mbrapa tij dhe i ka thënë se ky person (dëshmitari i referohet të pandehurit) të ka goditur. Kur e ka kthyer kokën, aty ka qenë kolegu i tij si dhe këtu i pandehuri dhe siç e ka përshkruar, i ka thënë F... se ky të ka goditur, nuk e di me çka e ka goditur, ka pas shumë njerëz përreth, ka tentuar ta kapë të pandehurin por nuk ka mundur për shkak të tollovisë. Në atë moment derisa ka tentuar ta kapë të pandehurin, të njëjtit i kanë rënë syzet në gjoks dhe në atë moment ka arritur t'i kapë vetëm syzat të cilat i ka futur në xhep, pra syzat e të pandehurit i ka pas në xhep. Tutje, ky dëshmitar, ka shtuar se e di që i pandehuri është larguar nga vendi i ngjarjes, ka shkuar diku dhe ka ndërruar rrobat dhe pas një kohe është kthyer prapë aty me rroba tjera. Për tu vërtetuar saktë se a ishte ky person, ju ka afruar dhe e ka pyetur se *“a mu dok a ishe ti me syza më herët”* dhe ai mu përgjigj *“po më kanë rënë dhe më kanë humbur syzat diku”*. Ka qenë terr pastaj për shkak të tollovisë së madhe ka ardhur drejtoresha e policisë bashkë me njësinë speciale, e di që është qetësuar situata. Gjithashtu ka theksuar se gjatë kohës kur ka tentuar ta kapë të pandehurin, persona të tjerë e kanë sulmuar nëpër trup, ku edhe është shqyer këmisha, mirëpo se kush kanë qenë këta persona tjerë nuk e din.

Dëshmitari H.... K...., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 09.01.2024, ka deklaruar se rastin i cili ka ndodhe me datën 05.02.2017, kur është djegur shtëpia e vëllaut A...., kujtohet e kam pas një lokal, lojëra të fëmijëve dhe kanë ardh disa fëmijë dhe kanë thënë që është kallur shtëpia e F.... (djali i vëllaut tim), atëherë kam vrapuar dhe kam shku te shtëpia e vëllaut, e pashë që ishte djegur shtëpia, pastaj kam shkuar te një shok që punonte taksist, ku vëllau im A.... bashkë me taksistin e kanë dërguar djalin e vëllaut tim te mjeku, në fillim nuk ishin policia dhe zjarrfikësit, nuk më kujtohet se a kanë ardhur policët apo zjarrfikësit të parët, por e di që kanë ardhur pastaj, kam hyrë në shtëpi me disa kojshi dhe i kemi nxjerrë disa dokumente dhe gjëra që kemi mundur, shtëpia është djegur mbas dite e di që ka qenë terr, nuk më kujtohet nëse ka pasur ndriçim publik apo jo. Po ashtu ka dëgjuar se djali H.... e ka sulmuar një polic të cilit nuk ia din emrin.

Dëshmitari I.... K...., në shqyrtimin gjyqësor me datë 09.01.2024, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me 09.02.2017, po ashtu ka theksuar se nuk e ka parë se kush e ka sulmuar policin, nuk ka dëgjuar se dikush ka goditur dikë, po gjatë djegies së shtëpisë është merr vetëm me shtëpinë, por vetëm ka dëgjuar duke u sharë sikur dojshin mu rreh dikush, dikush bërtitke, por vetëm ka dëgjuar se dikush e ka goditur polici por kush ka qenë nuk e dinë, por në lagje është folur se H.... e ka goditur policin.

Dëshmitari A.... K...., në shqyrtimin gjyqësor me datë 09.01.2024, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici të datës 08.02.2017, i cili ka theksuar se nuk e din nëse atë natë ka qenë edhe H...H... dhe nuk e din nëse ka qenë i njëjti e ka goditur policin, sepse në atë kohë e ka dërguar djalin e tij te mjeku dhe kur ishte kthyer gjithçka kishte përfunduar. Posa

kishte filluar zjarri janë grumbulluar shumë njerëz, kanë ardhur policia dhe zjarrfikësit dhe e kam thirr një fqinj me dërguar djalin te mjeku.

Dëshmitari F.... P..., në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.02.2024, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 06.02.2017, gjithashtu ka theksuar se atë ditë kur ka ndodhur rasti është djegur një shtëpi në lagjen R..., me urgjencë kemi shkuar ishin grumbulluar shumë njerëz dhe menjëherë kemi lajmëruara zjarrfikësit, disa persona të cilët kanë qenë rrezik kemi tentuar ti evakuojmë, aty kanë filluar sharjet dhe ofendimet nga ana e banorëve, prezent ka qenë edhe i pandehuri, por momentin që është acaruar situata kam kërkuara asistencë nga njësitë e tjerë, kanë qenë mbi 20 persona shumë agresiv, e kanë sulmuar kolegun R... por që sulmuesi kryesor ka qenë i pandehuri, i cili kur ka filluar ta sulmoj R..., e ka tërhequr R... i cili është munduar të mbrohej, përkatësisht të lirohej nga sulmi, goditjet i ka kapur në dorë syzat e të pandehurit.

Gjykata gjithashtu, bazuar në nenin 335 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, sipas propozimit të mbrojtësit, i mbështetur edhe nga Prokurori i Shtetit, ka lexuar deklaratën e dëshmitarit Q.... G..., tani ndjerë.

Në këtë deklaratë, të cilën ky dëshmitar e kishte dhënë në Zyrën e Hetimeve Rajonale të Policisë në Mitrovicë me datë 07.02.2017, dëshmitari kishte theksuar se kishte qenë përfaqësues i lagjes, ndërsa që me datë 05.02.2017, në shtëpinë e A... K..., ishte vërejtur zjarr. Gjithashtu, në deklaratën e dhënë, dëshmitari kishte theksuar se kishin shkuar edhe policia dhe zjarrfikësit dhe gjithashtu kishte theksuar se është e vërtetë se policia ishin penguar dhe sulmuar nga banorët e lagjes përkatësisht nga A... K..., I... K.... dhe H... K....

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: Deklarata e të dëmtuarit R.... N..., e dhënë në polici me datë 06.02.2017; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici, me datë 05.02.2017; Akt Ekspertimi mjeko-ligjor, i datës 06.09.2018, për të dëmtuarin R.... N....; Raporti mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Dr. Sami Haxhibeqiri-Emergjencia Mitrovicë, i datës 05.02.2017, me numër të protokollit 1634; Raporti i oficerit Rexhep Aliu, i datës 05.02.2017; Raporti i oficerit Behar Ahmeti, i datës 05.02.2017.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i pandehuri ka dhënë mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, i cili ka deklaruar se atë natë ka qenë në Teqe, se ka pasur një ceremoni për një rast vdekje, dikush nga fëmijët e lagjes ka ardhur dhe na ka lajmëruara se është djegur shtëpia e A... K..., të gjithë kemi shkuar të ndihmojmë në shuarjen e zjarrit, kur janë afruar afër shtëpisë që po digjej, ishin grumbulluar shumë njerëz të cilët kishin dalur për të ndihmuar, në atë moment nuk ka ardhur as policia as zjarrfikësit, dikush bërtiste pasi që rrezikoheshin edhe shtëpitë e tjera për djegie, aty mes tyre kam ndihmuar edhe zjarrfikësit, kush ka pasur problem nuk e di dhe mbas shuarjes së zjarrit është larguar në teqe për ta kryer ceremoninë, aty kanë ardhur policia dhe është arrestuar. Më tej ka shtuar se është përfaqësues i Romëve, më shumë se 10 vite ka pasur bashkëpunim të mirë me policinë, nuk e ka njohur zyrtarin policor-të dëmtuarin. Gjithashtu ka theksuar se nuk e ka sulmuar asnjë zyrtar

policor dhe asnjë person tjetër, nuk ka dëgjuar se kush e ka sulmuar policinë, e ka ndërruar këmishën për shkak të namazit ndërsa duke vrapuar për të shuar zjarrin, i kanë rënë syzet dhe nuk e di se kush i ka marr.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat personale dhe materiale, ka vërtetuara gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se ditën kritike, më datë 05.02.2017, në rrugën. “A... V...”, në lagjen e romëve në Mitrovicë, ishte djegur një shtëpi dhe se një numër i madh i njerëzve ishin mbledhur me qëllim që të ndihmonin në fikjen e zjarrit dhe se më pastaj, kishin shkuar edhe ekipet e policisë dhe zjarrfikësve.

Nuk ishte kontestuese fakti se i dëmtuari R.... N..., në ditën kritike ishte në vendin e ngjarjes dhe ishte në kryerje të detyrave zyrtare - zyrtar policorë, i njëjti sipas autorizimeve kishte shkuar në shtëpinë e cila po digjej, në rrugën “A... V...”, në lagjen e romëve në Mitrovicë dhe gjithashtu, për gjykatën, nuk ishte kontestues fakti se i dëmtuari R.... N..., ishte sulmuar atë ditë.

Gjykata vëren se kontestuese në këtë çështje penale ishte nëse i pandehuri e kishte sulmuar zyrtarin policor gjatë kryerjes së detyrave policor apo jo, gjë që i pandehuri në fjalën përfundimtare e ka mohuar dhe gjithashtu, nga ana e mbrojtjes është kontestuar edhe fakti nëse i dëmtuari kishte pësuar lëndime trupore apo jo.

Lidhur me këtë çështje, gjykata, pas administrimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vërtetuar faktin se i pandehuri e kishte sulmuar të dëmtuarin, personin zyrtar, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, R.... N.... – zyrtar policor, se gjatë vendosjes së rendit në lokacionin në të cilin po digjej një shtëpi, është goditur nga i pandehuri me grusht në regjionin e kokës dhe me atë rast, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjes së indeve të buta të kokës dhe qafës, dhe këtë fakt, gjykata e vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarit të dhënë në cilësi të dëshmitarit, dëshmia e dëshmitarit F... P... si dhe nga provat tjera të administruara në shqyrtim kryesor.

Nga dëshmia e dëshmitarit R.... N..., gjykata ka vërtetuar se ditën kritike, i njëjti, bashkë me kolegun e tij F... P..., se kanë pranuar informatë se është duke u djegur një shtëpi, kanë shkuar në lokacionin në fjalë në lagjen e Romëve në rrugën “A... V...”, shtëpia ishte duke u djegur dhe kishte pasur një turmë të madhe të njerëzve që ishin grumbulluar, ndërsa nga ana e banorëve kishte një revoltë ndaj policisë, menjëherë i kishin lajmëruar zjarrfikësit. Gjithashtu nga deklarata e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se në momentin që dëshmitari kishte kapur një djalë për ta larguar nga vendi ku po digjej shtëpia, i njëjti kishte rezistuar duke iu kundërvënë me fjalët “*mua mu ka djegur shtëpia, ju spo boni kurgjo, jeni ardhë me bo*

hajgare” dhe na atë moment, nga mbrapa, e ka goditur dikush në shpinë përkatësisht ndërmjet qafës dhe shpinës dhe kur është kthyer, kolegu i tij, F..., ka qenë mbrapa dëshmitarit dhe i ka thënë se ishte pikërisht i pandehuri që e kishte goditur dhe duke qenë se ka pasur shumë njerëz, ka tentuar ta kapë të pandehurin dhe por nuk ka mundur për shkak të tollovisë së madhe mirëpo ka arritur t’ia kapë vetëm syzet e të pandehurit. Nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se pasi që i pandehuri e kishte goditur, ishte larguar për një kohë nga vendi i ngjarjes, kishte ndërruar rrobat dhe përsëri ishte kthyer me rroba tjera. Gjithashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti, ditën kritike ishte dërguar në Spitalin e Mitrovicës për tretman mjekësor.

Gjykata ia ka falur në tërësi besimin deklaratës së dëshmitarit të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, sa i përket çështjes që ka të bëjë me sulmin që i pandehuri kishte ndërmarrë ndaj tij, kjo pasi që e njëjta ishte konsistente, përputhet pothuajse në tërësi me deklaratën që ka dhënë në fazat paraprake dhe atë në pjesët esenciale të saj, ishte e qartë, bindëse dhe për më tepër, gjen mbështetje edhe në provat tjera përkatësisht në dëshminë e dëshmitarit F... P.... por edhe në provat tjera materiale të administruara në shqyrtim kryesor.

Gjykata nuk ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari sa i përket faktit se i njëjti nuk ka pësuar lëndime, kjo për arsye sepse kjo bie ndesh me provat materiale siç janë Raporti Mjekësor i Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, i datës 05.02.2017 si dhe Akt ekspertimi mjeko ligjor, i datës 06.09.2018.

Nga dëshmia e dëshmitarit F... P..., gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën kritike, kishin pranuar një informatë se në lagjen e romëve, po digjej një shtëpi dhe me të parë zjarrin, kanë lajmëruar zjarrfikësit. Nga dëshmia e këtij dëshmitari, është vërtetuar se në vendin e ngjarjes kishte shumë njerëz, ndoshta me qindra, dhe pasi që kishin tentuar t’i evakujnë disa nga njerëzit që ishin në rrezik, kanë filluar sharjet dhe ofendimet nga ana e banorëve që ishin aty e ku prezent ishte edhe i pandehuri dhe se ndërkohe kishte shkuar edhe i dëmtuari, R..., dhe se i njëjti ishte sulmuar jo vetëm nga ana e të pandehurit, por edhe nga persona të tjerë dhe se për ta mbrojtur të dëmtuarin, e kishte tërhequr nga mbrapa. Nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar se ishte pikërisht i pandehuri që e kishte goditur kolegun e tij, këtu të dëmtuarin R... N.... dhe se në momentin kur është goditur i dëmtuari, kishte qenë 2-3 metra larg tij.

Gjykata ia ka falur në tërësi besimin deklaratës së këtij dëshmitari sa i përket faktit se ka qenë pikërisht i pandehuri ai i cili ditën kritike, e kishte goditur të dëmtuarin. Kjo për arsye sepse dëshmia e të njëjtit, ishte konsistente, e qartë dhe e besueshme për këtë Gjykatë. E besueshme për faktin sepse gjen mbështetje edhe në provat tjera, si personale, ashtu edhe ato materiale. Dëshmia e këtij dëshmitari, është në kohezion të plotë me dëshminë që kishte dhënë edhe i dëmtuari në shqyrtim gjyqësor, por edhe me provat materiale të administruara në shqyrtim kryesor.

Nga dëshmia e dëshmitarit H... K..., gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën kritike, kishte shpërthyer një zjarr në shtëpinë e vëllaut të tij, A... K..., se dëshmitari bashkë edhe me persona tjerë të lagjes, kishin provuar të ndihmonin në fikjen e zjarrit në këtë shtëpi, se në vendin e ngjarjes kishte një numër të madh të njerëzve por se nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari për faktin sepse i njëjti ishte konsistent në deklarinimin e tij, ishte në përputhje me deklaratën që kishte dhënë në fazat paraprake dhe për

më tepër, ishte në përputhje edhe me provat tjera të administruara dhe faktet të cilat janë provuar nga dëgjimi i këtij dëshmitari, ishin jo kontestuese për palët dhe gjykatën.

Nga dëshmia e dëshmitarit I... K..., gjykata ka vërtetuar faktin se në kohën kur kishte ndodhur përleshja me policinë, ndër të tjerë, aty kishte qenë edhe këtu i pandehuri H...H.... Gjithashtu edhe nga dëshmia e këtij dëshmitari, vërtetohet fakti se përkundër që i njëjti nuk e ka parë se kush e ka goditur policin, të dëmtuarin në këtë rast, i njëjti e ka dëgjuar në lagje se ishte pikërisht i pandehuri ai i cili e kishte goditur të dëmtuarin dhe gjithashtu ka vërtetuar faktin se ka parë shtyrje dhe ka dëgjuar sharje atë ditë.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari pasi që e njëjta ishte në harmoni me deklaratën që kishte dhënë ky dëshmitar edhe në polici dhe për më tepër, gjen mbështetje edhe në provat tjera materiale dhe personale, të administruara në shqyrtim kryesor.

Nga dëshmia e dëshmitarit A... K..., gjykata ka vërtetuar faktin se të njëjtit, ditën kritike, i është djegur shtëpia dhe me atë rast, lëndime ka pësuar djali i tij të cilin e kishte dërguar në Shtëpinë e Shëndetit. Gjithashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se ditën kritike kishte grumbull të madh të njerëzve dhe për shkak se kishte dërguar djalin e tij në spital, nuk kishte parë asgjë.

Faktet e njëjta sikurse në shqyrtim kryesor, ky dëshmitar i ka pohuar edhe në deklaratën e dhënë në polici, prandaj gjykata ia ka falur në tërësi besimin dëshmisë së këtij dëshmitari.

Këtë gjendje faktike, gjykata e ka vërtetuar edhe nga provat materiale dhe atë nga raportet e Policisë së Kosovës, përkatësisht raportet e oficerëve Behar Ahmeti, Rexhep Aliu dhe Sami Rustemi, vërtetohet se me datë 05.02.2024, njësi policor BC-202, pas informimit se në lagjen Rome në rrugën "A... V...", është duke u djegur një shtëpi, kanë shkuar në atë lokacion dhe kanë lajmëruara zjarrfikësit dhe në vendin e ngjarjes kanë qenë më shumë se 300 persona, dhe me të dal nga automjeti zyrtar, kanë filluar t'i fyenin dhe është sulmuar i dëmtuari zyrtari policor R... N..., dhe të njëjtin e kanë dërguar për tretman mjekësor në Spitalin Rajonal të cilit i është dhënë ndihma mjekësore, ndërsa zyrtari policor F... P... edhe pse ishte goditur në shpinë afër qafës nuk ka kërkuar tretman mjekësor.

Nga raporti mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Dr. Sami Haxhibeqiri - Emergjenca Mitrovicë, i datës 05.02.2017, me numër të protokollit 1634, vërtetohet se i dëmtuari R... N..., rreth orës 18:50 minuta, ishte pranuar për tretman mjekësor, i ishte përshkuar diagnoza por edhe një terapi përkatësisht medikamente.

Një gjendje e tillë faktike, se i dëmtuari kishte pësuar lëndime të lehta trupore, vërtetohet edhe nga provat materiale si raporti i ekspertizës mjeko-ligjore, i datës 06.09.2018, i përpiluar nga Dr. Flamur Blakaj, ku theksohet se i dëmtuari ka ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe këto dëmtime, kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Gjykata ka vërtetuar se i dëmtuari nga veprimet - goditjet e të pandehurit, kishte pësuar lëndime të lehta trupore. I dëmtuari R... N... kishte pësuar lëndime të lehta trupore në formë

të ndrydhjes së indeve të buta të kokës dhe qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të cilat lëndime paraqesin dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata, këtë gjendje faktike sa i përket faktit se i dëmtuari ka pësuar dëmtime trupore dhe natyrës së dëmtimeve trupore për të njëjtin, e ka vërtetuar plotësisht nga ekspertiza mjekoligjore e datës 06.09.2018, lëshuar nga eksperti mjeko - ligjor Dr. Flamur Blakaj si dhe Raporti mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm Dr. Sami Haxhibeqiri - Emergjenca Mitrovicë, në emër të dëmtuarit R..... N....., i datës 05.02.2017, me numër të protokollit 1634.

Gjykata ka vlerësuar ekspertizën mjeko-ligjore në lidhje me lëndimet trupore për të dëmtuarin. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, ekspertiza e ekspertit mjeko ligjor është e bazuar në raportin mjekësor të lëshuar nga institucioni shëndetësor - mjeku përgjegjës përkatësisht nga foto dokumentacioni, e në të cilin raport të ekspertit mjeko ligjor, përshkruhen të gjitha elementet e nevojshme që identifikojnë institucionin që ka lëshuar raportin, datën, kohën dhe numrin e protokollit, në këtë raport, gjithashtu përshkruhen edhe lëndimet trupore për të dëmtuarin. Gjithashtu, ekspertiza mjeko ligjore përmban elemente të mjaftueshme mbi të cilat pa dyshim vërtetohet shkalla dhe natyra e lëndimeve trupore për të dëmtuarin, kjo ekspertizë përmban të dhënat mbi ekspertin mjeko ligjor, gjetjet dhe konstatimet e ekspertit, dokumentet mbi të cilat është mbështetur ekspertiza, diagnoza për të dëmtuarin, mendimin e ekspertit mbi natyrën e lëndimeve si dhe mendimin përfundimtar mbi dëmtimet dhe natyrën e dëmtimeve trupore për të dëmtuarin.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ndaj të pandehurit H.... H.... duke e shpallur të njëjtin fajtor, pasi që në bazë të provave të administruara, u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme se në veprimet e këtij të akuzuari, janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së.

Neni 410 paragrafi 1 i KPRK-së, ka përcaktuar se: *“1. Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.”*, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen, ka përcaktuar formën e cilësuar të kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 i nenit 410 të KPRK-së. Kjo dispozitë përcakton se: *“2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësi të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri H...., kishte ndërmarr veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale, ashtu që ditën kritike, me datë 05.02.2017, rreth orës 17:45 minuta, në Lagjen e R...., Rr. “A.... V....” në Mitrovicë, e kishte sulmuar të dëmtuarin – zyrtarin policor R... N...., derisa i njëjti, bashkë me koleg të tij, po mundohej të vendoste rregull dhe rend përreth një shtëpie e cila po digjej, pas së cilës, i pandehuri ishte

shmangur dhe kishte goditur të dëmtuarin nga mbrapa, në pjesën e kokës, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore. Gjykata rikujton se veprimet e të pandehurit, të përshkruara si më lart, kanë qenë qartazi të kundërligjshme, pasi që nuk lejohet cenimi i integritetit trupor, përmes veprimeve të tilla siç janë sulmi ndaj asaj që është më e çmueshmja e njeriut, e që është integriteti trupor, e që në këtë rast, sipas nenit 410 paragrafi 1 të KPRK-së, specifikisht mbrohet integriteti i personave zyrtar në dhe gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Përveç elementeve të përgjithshme, gjykata gjen se në veprimet e të pandehurit, janë përmbushur edhe elementet e veçanta të veprës penale. Kjo për faktin se i akuzuari e dinte se subjekti pasiv të cilin po e sulmonte, ishte person zyrtar, përkatësisht zyrtar policor. Gjithashtu, nga provat e administruara, nuk ishte fare kontestuese se i dëmtuari po ushtronte detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj, bashkë edhe me zyrtar tjerë policor, me qëllim të rivendosjes së rendit dhe rregullit në mesin e qytetarëve në dhe rreth shtëpisë e cila po digjej, dhe krejt kjo me qëllim që të shmangnin rrezikun për vet banorët e lagjes por edhe që të mundësonin kryerjen e punës së sigurt e të papenguar për zjarrfikësit me qëllim ndaljen e zjarrit. Në këtë rast, i pandehuri kishte vepruar me dashje direkte, ashtu që edhe pse ishte i vetëdijshëm se si rezultat i sulmit ndaj të dëmtuarit, përkatësisht goditjes nga mbrapa në pjesën e kokës, do të mund ta gjente ndonjë e keqe përkatësisht se mund të shkaktohet pasoja, respektivisht se po cenohet integriteti trupor i të dëmtuarit, e si rezultat i këtyre veprimeve, edhe është cenuar integriteti trupor i zyrtarit policor, këtu të dëmtuarit Reshat Nimani.

Se janë përmbushur elementet e veçanta të figurës së veprës penale nga paragrafi 2 i nenit 410 të KPRK-së, përkatësisht se nga veprimet e të dëmtuarit, është realizuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar nga provat materiale të administruara në shqyrtim kryesor dhe atë nga raporti i akt ekspertimit mjeko ligjor i datës 06.09.2018, lëshuar nga eksperti mjeko - ligjor Dr. Flamur Blakaj, ekspert mjeko ligjor pranë Institutit t Mjekësisë Ligjore. Nga ky raport, i përpiluar për të dëmtuarin, ishte konstatuar se i njëjti kishte pësuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjes së indeve të buta në regjionin e kokës dhe qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe këto dëmtime, kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Gjykata e ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit H..., ku i njëjti ka pretenduar se ditën kritike, ishin tubuar në teqe për një ceremoni fetare dhe ishin informuar se po digjej shtëpia e fqinjit, A... K..., se kishin dalur për të ndihmuar në fikjen e zjarrit, ka dëgjuar një zhurmë nga personat nga komuniteti i tij mirëpo se nuk e di se çfarë ka ndodhur, se kush me kë ka pasur problem, nuk e di dhe se i njëjti kishte ftuar banorët që të mos pengojnë punën e zjarrfikësve dhe të policisë, ndërsa ka mohuar që të ketë sulmuar policinë, mirëpo kjo, sipas vlerësimit të gjykatës, është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe pretendimet e të pandehurit janë në kundërshtim të plotë me provat e administruara.

Gjithashtu, kjo Gjykatë nuk ka marr në konsideratë theksimet e mbrojtësit të pandehurit si në fjalën përfundimtare se në këtë çështje penale nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, kjo pasi që siç ka thënë mbrojtësi, aktakuza mbështetet në deklaratimet e dëshmitarëve R... N... dhe F... P..., mirëpo deklaratimet e këtyre dëshmitarëve, sipas mbrojtësit, janë kundërthënëse, ndërsa sa i përket faktit se i dëmtuari ka pësuar lëndime, kjo sipas mbrojtësit nuk qëndron pasi që i dëmtuari ka deklaruar se nuk ka pësuar lëndime andaj në këtë rast, sipas mbrojtësit, kualifikimi i veprës është dashur të jetë neni 410 paragrafi 1 i KPRK-së, e që i bie se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mbrojtësit si në fjalën përfundimtare, janë të pa qëndrueshme, të pa argumentuara dhe në kundërshtim me provat që janë administruar në shqyrtim kryesor. Siç u elaborua edhe më lart, nga deklaratimet e të dëmtuarit R... N... dhënë në cilësi të dëshmitarit dhe dëshmitarit F... P..., qartazi është vërtetuar se sulmi është kryer pikërisht nga ana e të pandehurit, deklaratimet e këtyre dëshmitarëve, në pjesët esenciale, kanë qenë konsistente dhe në përputhje me deklaratimet që kanë dhënë në procedurën paraprake, të qarta, bindëse dhe në përputhje edhe me provat tjera, ndërsa sa i përket pretendimeve se nuk kishte lëndime trupore në palën e dëmtuar, kjo sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është e pa qëndrueshme dhe në kundërshtim të plotë me provat materiale siç është raporti i akt ekspertimit të ekspertit të mjekësisë ligjore, i cili në këtë akt ekspertim, ka përshkruar natyrën e lëndimeve të pësuar nga i dëmtuari, diagnozën dhe pasojat për shëndetin e të dëmtuarit. Prandaj pretendimet e mbrojtjes, gjykata i ka vlerësuar në kuptim të tentativave me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale e të pandehurit.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Rrethana rëndësuese në këtë çështje penale gjykata mori parasysh dashjen e lartë të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale dhe kontributin e tij esencial në këtë vepër penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore dhe shtetërore që paraqet kjo vepër penale pasi që cenon drejtpërdrejtë institucionin kryesor që siguron rendin publik dhe sigurinë e përgjithshme të vendit tonë, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar sjelljen përgjithësisht korrekte të pandehurit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata vendosi në bazë të nenit 460, pasi që i dëmtuari ka hequr dorë nga ajo kërkesë.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.767/2019, datë 13.03.2024

Procesmbajtësja
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.